

URDHËR
Nr. 42, datë 15.2.2024

PËR DELEGIM TË KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; dhe të ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, drejtues zjarrfikës Arben Cara, me detyrë drejtor i Trajnimit dhe Mbështetjes Logjistike të MZSH-së, në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së.
 2. Kompetencat e deleguara sipas pikës 1, të këtij urdhri, të ushtrohen deri në emërimin e drejtorit të përgjithshëm të MZSH-së, ose deri në shfuqizimin e këtij urdhri.
 3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z. Arben Cara, Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin, si dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse.
 4. Urdhri nr. 354 datë 9.11.2021, i ministrit të Brendshëm, “Për delegimin e kompetencave”, shfuqizohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla